



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 115/ 2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur, përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj, paraqitur për shkak të parregullsive gjatë procesit të zgjedhjeve në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 03.05. 2012, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 30.04.2012, nga subjekti politik LVV, dega në Ferizaj, me të cilën pretendohet se në shkollën “Ahmet Hoxha” në QV 2501y/10, gjatë tërë ditës persona të ndryshëm kanë tentuar të votojnë, megjithëse komisionerja LVV-së sipas parashtruesit të ankesës nuk i ka lejuar të votojnë më arsye se kanë patur gishtat e spërkatur. Kjo ka ndodhur nga ora 14:22 deri në ora 15: 14 ndërsa rreth orës 18:35 një person ka tentuar të votojë dhe pasi zyrtari i KKZ-së në Ferizaj Idriz Hetemi, e ka thirr në telefon Majlinda Ramadanin dhe i ka thënë ti lejojë të votojnë. Madje ajo, sipas parashtruesit të ankesës, është kërcënuar nga këta persona duke i thënë që kanë një vërtetim të lëshuar nga Idriz Hetemi. Sipas parashtruesit të ankesës kjo përbënë shkelje të nenit 177 dhe nenit 316 të Kodit penal.

PZAP-i, e informoi zyrtarin e KKZ-së, Idriz Hetemin nëpërmes postes elektronike, më datë 01.05.2012, për ankesën në të cilën është përmendur edhe emri tij dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës në fjalë deri më datë 02.05.2012, në ora 14:00. PZAP-i, brenda afatit të caktuar mori përgjigjen e kërkuar nga zyrtari i KKZ-së, Idriz Hetemi lidhur me ankesën e paraqitur nga LVV-ja. Në të cilën theksohet se në lidhje me rastin nuk ka lëshuar vërtetim për të votuar për asnjë person të cilët më parë kanë votuar, thotë se për këtë çështje për të lejuar të votojë apo mos të votojë janë kompetent anëtarët e KVV-së të vendvotimit përkatës, ndërsa zyrtari i KKZ-së thekson se kam marrë një telefonat nga kryesuesi i këtij vendvotimit dhe ju kam përgjigj se unë e kam shkruar emrin e tij por ju e gjeni emrin e tij dhe nëse konstatohet se ka nënshkruar pran emrit të tij se ka votuar atëherë refuzoni, pasi që çdo votues e ka emrin në një vendvotim. Majlinda Ramadani e nominuar për anëtare e KVV-së nga subjekti politik LVV në vend që të kërkon këshilla ligjore menjëherë ma ka kërkuar numrin tim

personal, si dhe sjellja e saj nuk ka qenë e mirë dhe le të jetë në ndërgjegjen e saj, pasi që nuk e njoh personalisht dhe se besoj që më njeh as ajo.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

Ankesa është e pabazuar.

Ankuesi në ankesë pretendon se në vendvotimin 2501 y/10, zyrtari i KKZ-së, Idriz Hetemi ka lejuar të votojnë personat të cilët më parë kishin votuar. PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë për faktin se nuk janë dhënë prova dhe dëshmi bindëse që do ti argumentonin pretendimet e tilla ankimore, pasi që nuk është vërtetuar se cili ka qenë ai dokument zyrtar i lëshuar nga zyrtari i KKZ-së, me të cilin kinse është lejuar që të votojnë përsëri qytetarët të cilët kishin votuar më parë, një pretendim i tillë i ankesës u vlerësua si i pa bazë dhe i pa argumentuar, andaj në kuptim të nenit 115.1 lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

A nr. 115/2012 më datën 03.05.2012.

**Kryesuesi i panelit
Muharrem Shala**

